



Ky projekt financohet  
nga Bashkimi Evropian



**PARTNERËT SHQIPËRI**  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

---

# Raporti i monitorimit të Pjesëmarrjes Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve

---

Shqipëria 2022



# HUBRinor

BALLKANI PERENDIMOR DHE TURQIA

## Hulumtues

Era Sherifaj

## Kontribues

Jonida Alite

## Grafika dhe Faqosja

Maris Selamaj

Ky raport monitorimi u përgatit si pjesë e projektit Punësimi i të Rinjve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, financuar nga Bashkimi Evropian. Projekti zbatohet nga Fondacioni Ana & Vlade Divac (Serbi), Organizata Prima (Mali i Zi), Aleanca Rinore (Maqedonia e Veriut), Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (Shqipëri) dhe Fondacioni i Komunitetit të Vullnetarëve (Turqi).

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



# Në brendësi të këtij raporti



**Hyrje – Rreth projektit  
dhe raportit të  
monitorimit**

Faqja 3



**Të dhëna nga  
pjesëmarrja politike,  
sociale dhe  
ekonomike të të  
rinjve.**

Faqja 5



**Krahasimi i të  
dhënave përgjatë 7  
viteve të  
monitorimit.**

Faqja 11



**Rekomandime dhe  
çështjet për  
advokim.**

Faqja 14



**Shtojca 1-  
Metodologjia e  
studimit.**

Faqja 17

# Hyrje – Rreth projektit dhe Raportit të Monitorimit

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim në kuadër të projektit “Punësimi i të rinjve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë” i cili zbatohet në partneritet me fondacionin “Ana dhe Vlade Divac” në Serbi, “Aleancën Rinore” në Maqedoninë e Veriut, organizatën “Prima” në Mal të Zi dhe “Fondacionin e Komunitetit të Vullnetarëve” në Turqi, prej vitit 2016, harton “Raportin e Monitorimit të Pjesëmarrjes Politike, Sociale dhe Ekonomike të të rinjve në Shqipëri” duke kontribuar në zhvillimin e Raportit Rajonal që prezanton situatën e të rinjve në këto 5 vende.

Gjatë shtatë viteve të fundit, raporti i monitorimit është publikuar si një mekanizëm për të kuptuar përfshirjen e të rinjve në kontekstin politik, ekonomik dhe social në Shqipëri. Raporti ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të mundësive për të rinjtë, përmes lentes së 25 indikatorëve të pjesëmarrjes sociale, ekonomike dhe politike.


- **Dimensioni politik** i referohet mundësive të të rinjve për përfshirje në proceset politike, për t'u zgjedhur në poste politike, për t'u informuar për punën e qeverisë, parlamentit dhe bashkive, si dhe për të marrë pjesë në rrjete rinore.
- **Dimensioni ekonomik** i referohet shkallës së përfshirjes ose, të kundërtën, përjashtimit të të rinjve nga tregu i punës. Ky indikator mat shkallën e aktivitetit, të punësimit dhe vetëpunësimit të të rinjve.
- **Dimensioni social** i referohet pjesëmarrjes aktive të të rinjve në jetën shoqërore. Ai vlerësohet në bazë të integritetit të të rinjve në komunitet nëpërmjet edukimit formal dhe joformal, apo mungesës së treguesve të përjashtimit të mundshëm të të rinjve nga jeta shoqërore – për shkak të varfërisë, sa të varur janë ata në sistemin e mirëqenies sociale apo kohës së kaluar në burg ose në institucionet e riedukimit.

Raporti është një mjet konkret që mund të përdoret nga institucionet shtetërore dhe OSHC-të për të identifikuar dhe trajtuar në mënyrë sistematike sfidat më urgjente të pjesëmarrjes aktive të të rinjve në Shqipëri. Ai kontribuon në:

- Krahasimin e të dhënave sipas indikatorëve kryesorë të pjesëmarrjes së të rinjve: politike, ekonomike dhe sociale;
- Monitorimin e progresit të pjesëmarrjes së të rinjve në Shqipëri ndër vite;
- Advokim për zbatimin e politikave dhe programeve që synojnë përmirësimin e pjesëmarrjes së të rinjve.

Raporti për Shqipërinë për vitin 2022 ofron një analizë të të dhënave të mbledhura përmes hulumtimeve dhe kërkesave zyrtare për informacion dërguar institucioneve përgjegjëse siç janë: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Instituti Kombëtar i Statistikave, si dhe të 61 Bashkive në vend.

Të dhënat e këtij raporti janë reflektuar gjithashtu në raportin rajonal për vitin 2022 “Indexi i Pjesëmarrjes së të Rinjve”, i cili paraqet të dhëna krahasuese nga 5 shtetet (Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, dhe Turqia).




**“Pavarësisht iniciativave të ndërmarra për të fuqizuar të rinjtë në Shqipëri, ende nuk ka rezultate pozitive dhe konkrete të reflektuara në të dhënat aktuale”**

# Të dhëna për Pjesëmarrjen Politike të të Rinjve

INDIKATORËT	TOTALI	FEMËR	MASHKULL	VITI
Ministrat e rinj në qeveri	0.0%	0.0%	0.0%	2022 <sup>1</sup>
Zëvendësministrat e rinj në qeveri	3.0%	3.0%	0.0%	2022 <sup>1</sup>
Deputetët e rinj në parlament	1.5%	0.7%	0.7%	2022 <sup>1</sup>
Kryebashkiakë të rinj	0.0%	0.0%	0.0%	2022 <sup>1</sup>
Mjete on-line për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrjen e qeverisë dhe parlamentit	90%			2022 <sup>1</sup>
Mjete on-line për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrjen e bashkive	76%			2022 <sup>1</sup>
Ekzistenca e strukturave rinore (këshillat / parlamentet / bordet) në nivel kombëtar.	Po			2022
Ekzistenca e strukturave rinore (këshillat / parlamentet / bordet) në nivel lokal	74.0%			2022 <sup>2</sup>

[1] Hulumtim

[2] Kërkesë për Informacion nga 61 Bashkitë e Shqipërisë



“Në vitin 2022, Shqipëria shënon një moment të rëndësishëm me ngritjen e një numri të konsiderueshëm strukturash rinore në nivel lokal”

# Të dhëna mbi Pjesëmarrjen Sociale të të Rinjve

INDIKATORËT	TOTALI	FEMËR	MASHKULL	VITI
Të rinj në rrezik varfërie	Nuk ka të dhëna	-	-	2022 <sup>3</sup>
Përqindja e të rinjve të varfër (të rinjtë që jetojnë nën vijën e varfërisë) (Jo i të rinjve të varfër / jo i të rinjve)	Nuk ka të dhëna	-	-	2022
Të rinj në burgje	36.9%	0.3%	36.6%	2022 <sup>4</sup>
Të rinjtë pjesë e sistemit të mbrojtjes sociale	Nuk ka të dhëna	-	-	2022 <sup>5</sup>
Braktisja e shkollës së mesme	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	2021-2022 <sup>6</sup>
Të rinjtë e regjistruar në arsimin e lartë	22%	26.3%	17.7%	2019-2020 <sup>7</sup>
Të rinjtë e diplomuar në arsimin e lartë	24.9%	28.2%	19.9%	2019-2020 <sup>7</sup>
Shkalla e pjesëmarrjes në arsimin dhe trajnimin joformal (4 javët e fundit)	%	%	%	2021 <sup>8</sup>

[3] Partnerët Shqipëri dërguan një kërkesë për informacion pranë Institutit Kombëtar të Statistikave, por ata u përgjigjën se këto të dhëna nuk janë publikuar ende për vitin 2022

[4] Kërkesë për Informacion në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve

[5] Partnerët Shqipëri i dërgoi një kërkesë për informacion Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

[6] Partnerët Shqipëri i dërgoi një kërkesë për informacion Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

[7] Kërkesë për informacion pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT)

[8] Kërkesë për informacion pranë Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT)



---

“Vazhdon të ketë hapësira  
dhe mungesa në  
monitorimin,  
kuptimin dhe adresimin  
e problematikave të të  
rinjve vulnerabël në  
Shqipëri.”

---

# Të dhëna për Pjesëmarrjen Ekonomike të të Rinjve

INDIKATORËT	TOTALI	FEMËR	MASHKULL	VITI
Norma e NEET (jo në edukim, punësim, trajnim)	25.2%	27.8%	22.6%	2022 <sup>8</sup>
Shkalla e papunësisë të të rinjve	20.72%	20.73%	20.70%	2022 <sup>8</sup>
Shkalla e papunësisë afatgjatë të të rinjve	12.5%	11.7%	13.3%	2022 <sup>8</sup>
Shkalla e pjesëmarrjes si forcë punëtore të të rinjve	55.5%	50.6%	60.5%	2022 <sup>8</sup>
Shkalla e punësimit të të rinjve	44%	40.1%	48%	2022 <sup>8</sup>
Të rinjtë që themeluan biznesin e tyre me mbështetjen financiare të shtetit	4.5%	5.1%	4.4%	2022 <sup>9</sup>
Të rinjtë e vetëpunësuar	16.6%	12.4%	20.2%	2022 <sup>8</sup>

---

“Në 7 vite monitorim,  
pabarazitë gjinore në treguesit  
e dimensionit ekonomik  
vazhdojnë të jenë të dukshme.  
Vajzat e reja vazhdojnë të  
përballen me vështirësi për të  
pasur mundësi të barabarta,  
për të kontribuar  
ekonomikisht dhe për të  
arritur pavarësi financiare”.

---

# Krahasimet e të dhënave gjatë 7 viteve të monitorimit

Në përgjithësi, disa indikatorë kanë ndryshuar si pozitivisht dhe negativisht ndër vite, por krahasuar me të dhënat e prezantuara në raportin e parë, shtatë vite më parë, vërehet një përmirësim i dukshëm.

## DIMENSIONI I PJESËMARRJES POLITIKE

Vihet re një përfaqësim i ulët i të rinjve në qeveri. Në harkun kohor të shtatë viteve, asgjë **nuk ka ndryshuar në përfaqësimin e ministrave të rinj** në qeverinë shqiptare, duke mbetur i pandryshuar në nivelin 0%. Moshja mesatare e ministrave është 45 vjeç, ndërsa gratë mbajnë rreth 81% të posteve në ministri.

Në vitin 2022, vetëm një grua e re (18 – 29 vjeç) mban postin e zëvendësministres në qeveri. Numri më i lartë i zëvendësministrave të rinj (2) ka qenë në vitin 2019.

Për më tepër, edhe **numri i deputetëve të rinj** (18 – 29 vjeç) **ka qenë i ulët ndër vite**, duke shfaqur një tendencë në rënie, veçanërisht në dy vitet e fundit.

### **Ndërkohë numri i kryetarëve të bashkive të grupmoshës 18 – 29 vjeç, nga viti 2018 deri aktualisht ka qenë 0.**

Për sa i përket aksesit të informacionit online, pjesa më e madhe e institucioneve qeveritare në Shqipëri ofrojnë informacion nëpërmjet platformave digjitale. Vetëm disa, ndoshta një ose dy prej tyre, mund të kenë mungesë të mjeteve online për informim. Megjithatë, një prej ministrave nuk ka asnjë mjet informimi online. Është e dukshme se bashkitë kanë gjithë mjetet e nevojshme për ndarjen e informacionit dhe nxitjen e pjesëmarrjes qytetare në procese vendimmarrëse. Të gjitha bashkitë kanë një faqe zyrtare në internet dhe një llogari në Facebook dhe Instagram. Ndërkohë Twitter, nuk përdoret shpesh në kontekstin shqiptar. Në disa raste është konstatuar se, në vend të llogarive zyrtare të bashkive, shpesh ka llogari që u përkasin kryetarëve të bashkive të cilët në mënyrë aktive ndajnë informacion për aktivitetet e kryera dhe zhvillimet e fundit.

Vitet e fundit në Shqipëri janë ndërtuar struktura të rëndësishme për të rinjtë, duke përfshirë “Agjencinë Kombëtare të Rinisë”, “Këshillin Rinor Kombëtar” dhe “Kongresin Rinor Kombëtar”, struktura të angazhuara në mënyrë aktive në fuqizimin e të rinjve në Shqipëri.

Njëkohësisht, prania **e strukturave rinore në nivel lokal ka arritur nivelin e saj më të lartë në Shqipëri**. Në përputhje me ligjin nr. 75/2019 “Për të rinjtë”, bashkitë kanë ndërmarrë iniciativë për krijimin e “Këshillave Rinor” vendorë. Aktualisht, 74% e bashkive kanë themeluar me sukses këshillat rinor dhe po bëhen përpjekje për të krijuar organe të ngjashme në qytetet e mbetura.

## DIMENSIONI I PJESËMARRJES EKONOMIKE

Në përgjithësi, shumica e indikatorëve të pjesëmarrjes ekonomike të të rinjve në Shqipëri, ka pasur një përmirësim të lehtë.

Ka një tendencë pozitive dhe **një rënie graduale të normës së përgjithshme NEET në Shqipëri** nga viti 2016 në 2022, duke arritur vlerën më të ulët në vitin 2022 në 25.2%. Gjatë gjithë viteve, ka pasur një hendek të dallueshëm gjinor në normën NEET, me të rejat (18-29 vjeç) që shfaqin vazhdimisht norma më të larta krahasuar me të rinjtë (18-29 vjeç). Për shembull, në vitin 2022, shkalla e NEET për të rejat (27.8%) ishte më e lartë se ajo e të rinjve (22.6%) me 5.2%, duke nënkuptuar një përqindje më të madhe të të rejave (18-29 vjeç) që nuk marrin pjesë në arsim, punësim ose trajnim.

**Zhvillim pozitiv ndër vite ka pasur edhe indikator i papunësisë së të rinjve në Shqipëri**, duke u ulur me 9.08%, nga viti 2016 (29.8%) në 2022 (20.72%). Shkalla e papunësisë për të rejat (18-29 vjeç) është pak më e lartë se ajo e të rinjve (18-29 vjeç), tregues se të rejat hasin më shumë vështirësi në punësim.

Ndërkohë, **shkalla e papunësisë afatgjatë ka pësuar një rritje të lehtë** prej 1.1% në dy vitet e fundit, veçanërisht e dukshme tek të rinjtë, ku ka pasur një rritje prej 1.7 % nga viti 2021 (11.6%) në 2022 (13.3%). Për më tepër, papunësia afatgjatë tek të rinjtë (13.3%) tejkalon atë të të rejave (11.7%), me një diferencë prej 1.6% në vitin 2022.

**Pjesëmarrja e të rinjve në fuqinë punëtore** është rritur vazhdimisht, duke arritur përqindjen më të lartë prej 55.5% në vitin 2022. Megjithatë, ka pabarazi të dukshme gjinore në pjesëmarrjen e të rinjve në fuqinë punëtore. Në të gjitha vitet dhe në vitin 2022, shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve në fuqinë punëtore (60.5%) ka qenë dukshëm më e lartë krahasuar me të rejat (50.6%).

Të dhënat tregojnë një trend rritës në **normën e punësimit të të rinjve në Shqipëri**. Nga 32.4% në vitin 2016, shkalla e punësimit është rritur në 44% në 2022. Punësimi i të rinjve në vitin 2022 dhe në të gjitha vitet e studimit është veçanërisht më i lartë se ai i të rejave.

Për sa i përket sipërmarrjes, mbledhja e të dhënave të sakta për numrin e të rinjve që nisin bizneset e tyre me mbështetjen financiare të shtetit, mbetet sfiduese në Shqipëri. Kjo për shkak të mungesës së statistikave zyrtare për numrin e tyre.

Si alternativë, ky tregues është llogaritur duke marrë në konsideratë përfituesit e skemave mbështetëse financiare të ofruara nga qeveria (mbështetja financiare totale e ofruar nga çdo ministri për të rinjtë). Sipas të dhënave në vitin 2022, 4.5% e përfituesve nga skemat financiare të ofruara nga ministritë janë të rinj, ku përqindja e të rejave përfituese (5.1%) është më e lartë se e të rinjve përfitues (4.4%). Në përgjithësi, vetëm 0.13% e të rinjve e nisin biznesin e tyre me mbështetjen e qeverisë.

**Shkalla e të rinjve të vetëpunësuar shfaq luhatje të konsiderueshme ndër vite.** Pas një rënie të ndjeshme nga viti 2016 (29%) në 2018 (0.9%), u shënuar një rritje e ndjeshme (18.5%) në 2019. Shkalla e vetëpunësimit në Shqipëri vazhdon të ketë luhatje, dhe në vitin 2022 është 16.6%, duke treguar një rënie në dy vitet e fundit. Përgjatë viteve, shkalla e vetëpunësimit tek të rinjtë është më e lartë krahasuar me të rejat.

Në përgjithësi, të rinjtë vazhdojnë të kenë një përfshirje më të mirë sesa të rejat në shkallën e punësimit, pjesëmarrjen në fuqinë punëtore dhe shkallën e vetëpunësimit, dhe një përqindje më të ulët në NEET dhe në shkallën e papunësisë.

## DIMENSIONI I PJESËMARRJES SOCIALE

Ndër vite, **të dhënat për disa prej indikatorëve të “Dimensionit të Pjesëmarrjes Sociale” janë të limituara**, veçanërisht për përqindjen e të rinjve të varfër dhe të rinjve pjesë e sistemit të mirëqenies sociale.

Megjithatë, të dhënat për të rinjtë në rrezik varfërie janë të disponueshme, dhe që nga viti 2017 maten çdo vit nga “Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri” (INSTAT). Të dhënat për vitin 2022 do të publikohen në fund të dhjetorit 2023.

Përqindja e **të rinjve në rrezik varfërie shfaq luhatje ndër vite**, duke shënuar një rënie veçanërisht në dy vitet e fundit. Për më tepër, ekziston një pabarazi e dukshme gjinore. Rreziku i varfërisë ka qenë vazhdimisht më i lartë tek të rejtat në krahasim me të rinjtë ndër vite. Ndërsa përqindja e të rinjve të rrezikuar nga varfëria është ulur me 3.7% nga viti 2017 në 2021, përqindja e të rejave në rrezik varfërie është rritur me 1%. Në vitin 2021 përqindja e të rinjve në rrezik varfërie ishte 2.2% më e lartë se përqindja e popullsisë totale në rrezik varfërie, duke rezultuar në një nga grupet me rrezikshmërinë më të lartë për të rënë në varfëri.

Të dhënat për **përqindjen e të rinjve të varfër** vijojnë të mos maten apo të sigurohen nga INSTAT dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale gjatë viteve 2017-2022.

Në vitin 2022, **të dhënat për të rinjtë në sistemin e mirëqenies sociale** mbeten të pjesshme, me informacion të kufizuar për grupmosha të ndryshme, përveç atyre të moshës 15-29 vjeç. Ndër tre programet e ndihmës sociale, ka të dhëna vetëm për të rinjtë, përfitues të skemës së shërbimeve të përkujdesit shoqëror. 11.3% e përfituesve të shërbimeve sociale janë të rinj, një numër i konsiderueshëm të rinjsh përfitues brenda sistemit të mirëqenies sociale. Gjithashtu, përqindja e të rejave që kanë nevojë për shërbime dhe janë pjesë e sistemit të shërbimeve të përkujdesit të shoqëror është më e lartë se ajo e të rinjve.

**Të dhënat për të rinjtë në burgje tregojnë një tendencë të paqëndrueshme ndër vite.** Në vitin 2022 përqindja e të rinjve në burgje është e njëjtë si në vitin 2021, 36,9%, ku shumica e të burgosurve (36,6%) ishin të rinj. Një përmirësim i dukshëm vihet re, pasi numri i të rinjve në burgje është ulur me 10,8% në vitin 2022 (36,9%) në krahasim me vitin 2018 që shënon përqindjen më të lartë të të rinjve në burgje me 47,7%.

Ndër vite, ndërkohë që ka pasur ndryshime të lehta **në përqindjen e të rinjve të regjistruar në arsimin e lartë**, përqindjet kanë qenë në përgjithësi relativisht konsistente. Në vitin 2022, përqindja e të rinjve (18-29) të regjistruar në arsimin e lartë është 22%. Gjithashtu, vihet re një hendek konsistent gjinor edhe në këtë tregues, ku regjistrimi i të rejave është dukshëm më i madh se ai i të rinjve. Në vitin 2022, përqindja e të rejave të regjistruara në arsimin e lartë është 8,6% më e lartë se përqindja e të rinjve.

Ndërkohë **shkalla e diplomimit të të rinjve nga arsimi i lartë** është 24,9% në vitin 2022, 1,1 % më e ulët se vitin e kaluar (26%). Edhe pse ka ndryshime të lehta nga viti në vit, tendenca e përgjithshme tregon një rritje pozitive të shkallës së diplomimit. Shkalla më e lartë e diplomimit është vërejtur në vitin 2019 me 26.7%, duke demonstruar një trajektore pozitive në pjesëmarrjen në arsimin e lartë. Pabarazia gjinore në normën e diplomimit vazhdon, me të rejtat që shfaqin vazhdimisht norma më të larta krahasuar me të rinjtë. Për shembull, përqindja e të rejave që mbarojnë arsimin e lartë (28.2%) në 2022 është 8.3% më e lartë se përqindja e të rinjve të diplomuar (19.9%).

Në krahasim me të rinjtë, të rejtat tregojnë një nivel më të lartë përkushtimi ndaj arsimit dhe kanë një përqindje më të ulët të braktisjes së arsimit të mesëm, një gatishmëri më të lartë për tu regjistruar në arsimin e lartë dhe një raport më të lartë diplomimit në arsimin e lartë.

# Rekomandime dhe çështje për advokim

Ky sesion synon të ofrojë rekomandime për politika, iniciativa dhe strategji për aktorët dhe institucionet që në mënyrë efektive të adresojnë dhe advokojnë për ndryshime pozitive të politikave në fushën e rinisë.

## REKOMANDIME PËR PJESËMARRJEN POLITIKE TË TË RINJVE

Situata në lidhje me përfshirjen e të rinjve në politikë në Shqipëri nuk ka pasur përmirësime ndër vite, dhe të rinjtë vazhdojnë të jenë të nënprezantuar në pozicione politike, si kryetar bashkie, zëvendësministër apo ministër. Të dhënat tregojnë qartë se Shqipëria ka ende nevojë të ndër marrë hapa të rëndësishëm drejt një sistemi politik më gjithëpërfshirës, që angazhon dhe përfaqëson në mënyrë aktive të rinjtë.

Disa rekomandime që duhen marrë në konsideratë për të përmirësuar pjesëmarrjen politike të të rinjve në Shqipëri janë si më poshtë:

- Qeveria, parlamenti, partitë politike dhe organizatat rinore duhet të **prezantojnë politika** dhe të **zhvillojnë strategji/programe** të qëllimshme për të rritur përfaqësimin e të rinjve në politikë.

Është shumë e rëndësishme që institucionet qeveritare, si në nivel vendor dhe qendror, të vendosin kuota ose mekanizma specifikë për të siguruar që të rinjtë të kenë një prani domethënëse në vendimmarrje. Duhet të ndërmerren nisma për të rritur ndërgjegjësimin, për të ofruar informacion, dhe për të inkurajuar e mbështetur të rinjtë për t'u angazhuar më aktivisht në politikë. Për më tepër, është e rëndësishme të ofrohen programe mentorimi, trajnime dhe të sigurohen burimet e nevojshme për të përgatitur talentet e rinj/reja për pozicionet e ardhshme drejtuese.

Duhet të inkurajohet përfshirja e përfaqësuesve të grupeve të ndryshme të të rinjve në vendimmarrje dhe konsultime, për të mundësuar reflektimin e nevojave të tyre në politika dhe strategji. Gjithashtu, duhet të lehtësohet përfshirja e të rinjve në nivele të ndryshme të pozicioneve drejtuese, duke u ofruar atyre ekspozim, eksperiencë dhe informacion. Kjo do të fuqizojë të rinjtë të përgatiten për të marrë role drejtuese brenda institucioneve kryesore në Shqipëri.

- **Të forcohet fuqizimi dhe funksionaliteti i strukturave të ngritura rinore** (këshillat/parlamentet/sindikatat) për të siguruar pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e vendimmarrjes.

Ngritja e Këshillave Vendor Rinor (KVR) po përparon pozitivisht, ku shumica e bashkive kanë ngritur me sukses KVR-të e tyre, ndërsa të tjerat janë në proces krijimi. Megjithatë, për të garantuar funksionalitetin dhe efektivitetin e strukturave rinore, është e rëndësishme zbatimi i masave që shkojnë përtej shkrimit të tyre në letër. Këto struktura duhet të fuqizohen dhe aktivizohen me një strategji të qartë për të përmbushur funksionet e synuara. Kjo përfshin zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve angazhuese që përfshijnë në mënyrë aktive të rinjtë. Gjithashtu, duhet të prezantohen dhe mekanizma vlerësimi dhe monitorimi në mënyrë të rregullt për të matur performancën dhe impaktin e këtyre strukturave rinore, duke u siguruar që ato kontribuojnë në fuqizimin dhe angazhimin e të rinjve.

- Institucionet publike duhet t'i japin përparësi **përdorimit efektiv të mjeteve online** për të përmirësuar komunikimin me të rinjtë.

Edhe pse ka një numër të mjaftueshëm të mjeteve online që përdoren për informimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje si në nivel vendor ashtu edhe në nivel qendror, është e nevojshme që këto mjete të përdoren efektivisht, duke i bërë ato më transparente dhe të aksesueshme për të siguruar që zëri i të rinjve të dëgjohej dhe nevojat e tyre të adresohen.

Institucionet publike duhet të përdorin mjete online të përshtatshme dhe lehtësisht të përdorueshme, për të prezantuar fushatat, për të postuar informacione të përditësuara, dhe për të krijuar forume ndërvepruese duke siguruar kështu pjesëmarrje aktive të të rinjve. Përdorimi i platformave të njohura të mediave sociale (instagram, tik-tok, etj) dhe partneriteti me organizata të drejtuara nga të rinjtë, mund të përmirësojnë pjesëmarrjen dhe të rrisin impaktin e mjeve të informimit online. Kjo përqsasje nxit transparencën, aksesueshmërinë, gjithëpërfshirjen dhe vendimmarrjen e informuar.

## REKOMANDIME PËR PJESËMARRJEN EKONOMIKE TË TË RINJVE

Miratimi i strategjive të reja si “Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani i Veprimit 2022-2029”, “Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030” dhe “Garancia Rinore” janë nisma premtuese për përmirësimin e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës, duke prezantuar kështu një mundësi për zhvillimin e situatës ekonomike të të rinjve në Shqipëri.

Edhe pse ka një trend pozitiv në indikatorët e pjesëmarrjes ekonomike të të rinjve, me zhvillime të rëndësishme dhe hapa konkret, ka akoma sfida dhe problematika në indikator specifikë të cilat kërkojnë vëmendje dhe masa të menjëhershme.

Shkalla e NEET në Shqipëri vazhdon të jetë mbi 25%, dhe shkalla e papunësisë mbi 20%. Për të ulur këtë nivel të lartë të NEET dhe shkallën e papunësisë, institucionet përgjegjëse duhet të luajnë një rol të rëndësishëm veçanërisht në identifikimin e të rinjve në NEET dhe zbatimin efektiv të nismave të parashikuara në "Garancinë Rinore" dhe "Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive" për angazhimin e të rinjve në arsim, trajnim dhe punësim. Ndërkohë, për të ulur shkallën e papunësisë afatgjatë, duhet të zbatohen programe trajnimi për rikualifikimin dhe përmirësimin e aftësive, me synim lehtësimin e integritit në tregun e punës.

Rekomandohet krijimi strukturave të specializuara që lehtësojnë punësimin e të rinjve, dhe adresojnë nevojat e tyre të veçanta në kërkimin e pozicioneve të punës. Për të lehtësuar tranzicionin në punë duhet të ofrohen shërbime për orientimin dhe zhvillimin e karrierës, asistencë për përshtatjen në vendin e punës dhe trajnime të ndryshme.

- Zbatimi i **politikave ekonomike gjithëpërfshirëse në aspektin gjinor** që adresojnë dhe eliminojnë **barrierat gjinore** në sferën ekonomike dhe që synojnë të sigurojnë **akses, mundësi dhe burime të barabarta për të rejtat**.

Në vitin 2022, në krahasim me të rinjtë, të rejtat tregojnë nivele më të ulëta në punësim, pjesëmarrje në fuqinë punëtore, dhe vetëpunësim, si dhe regjistrojnë përqindje më të larta në NEET dhe normën e papunësisë afatgjatë. Prandaj duhet të ofrohet mentorim, trajnim dhe burime të nevojshme për fuqizimin e tyre në aktivitetet ekonomike.

Rritja e ndërgjegjësimit dhe zhvillimi i aftësive të të rejave, duke u fokusuar kryesisht në fushat e dominuara tradicionalisht nga të rinjtë do të sillte impakt. Kjo do të ndihmonte në kapërcimin e hendekut gjinor në industri si teknologji, inxhinieri dhe sipërmarrje. Gjithashtu, advokimi për politika gjithëpërfshirëse në aspektin gjinor është i nevojshëm brenda kompanive të sektorit privat, duke prezantuar incentiva dhe iniciativa që promovojnë diversitetin, barazinë, dhe praktikën e kompensimit në punë. Për më tepër, aplikimi i politikave që promovojnë ekuilibrin midis jetës personale dhe punës, siç janë oraret fleksibël dhe lejet për prindërit, mund të kenë një impakt thelbësor në rritjen e pjesëmarrjes së të rejave.



Të dhënat për vetëpunësimin dhe sipërmarrjen rinore tregojnë qartë se ekziston nevoja për të forcuar sistemin e mbështetjes për sipërmarrësit e rinj duke ofruar trajnime gjithëpërfshirëse, akses më të lartë në financa dhe programe mentorimi. Qeveria dhe sektori i shoqërisë civile duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë zbatimit të programeve që rrisin njohuritë financiare dhe aftësitë menaxhuese tek të rinjtë, duke i pajisur ata me njohuritë e nevojshme për të menaxhuar aspektet financiare dhe drejtimin e një biznesi.

Hapësirat e reja në Piramidën e Tiranës dhe “TUMO Tirana”, një qendër e gjithanshme e edukimit teknologjik për të rinjtë, jo vetëm që kultivon një mjedis të ri sipërmarrës, por gjithashtu ofron mundësi për sipërmarrësit e rinj të marrin me qira hapësira pune, të bashkëpunojnë me grupe të ndryshme interesi dhe të marrin pjesë në aktivitete që lidhen me teknologjinë, inovacionin dhe sipërmarrjen. Ky ambient do të shërbejë si një katalizator për inovacion dhe zhvillim brenda komunitetit të sipërmarrjes.

## REKOMANDIME PËR PJESËMARRJEN SOCIALE TË TË RINJVE

- **Iniciativa dhe burime** të krijuara posaçërisht për të **fuqizuar ekonomikisht të rinjtë**, veçanërisht gratë e reja, për të reduktuar vulnerabilitetin e tyre ndaj varfërisë.

Mungesa e të dhënave në dimensionin social, nënkupton hapësira të konsiderueshme në monitorimin, kuptimin dhe adresimin e vulnerabilitetit të të rinjve. Është thelbësor krijimi i një sistemi të standardizuar, transparent dhe të unifikuar për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave në të gjithë Shqipërinë. Kjo qasje e unifikuar, e mbështetur nga një metodologji e aksesueshme për publikun, do të rrisë saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave ekzistuese dhe do të mundësojë llogaritjen e saktë të treguesve kryesorë si të rinjtë në varfëri dhe ata të përfshirë në sistemin e mbrojtjes sociale. Mbledhja e të dhënave për të rinjtë vulnerabël u mundëson institucioneve përkatëse zbatimin e masave dhe politikave të përshtatura për nevojat e tyre, dhe që synojnë përmirësimin e kushteve të tyre, nxitjen e integritit të tyre në shoqëri, si dhe promovimin dhe përfshirjen e tyre në aktivitetet sociale.

Është i nevojshëm përmirësimi i programeve të asistencës sociale për të rinjtë, për të ofruar shërbime gjithëpërfshirëse, veçanërisht për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç si dhe dizenjimi i shërbimeve që adresojnë nevojat dhe rrethanat e tyre unike, brenda skemës së shërbimeve të përkujdesit social.

Duhet të ndërmerren nisma për të përmirësuar sistemin e drejtësisë për të rinjtë dhe për të eksploruar qasje alternative ndaj vuajtjes së dënimit së të rinjve. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rehabilitimit, nxitjes së zhvillimit të kapaciteteve dhe të aftësive, dhe lehtësimit të riintegritit në shoqëri pas vuajtjes së dënimit.

Duhet të ofrohen shërbime të orientimit dhe edukimit për karrierën, të udhëhequr nga ekspertë dhe koordinatorë të trajnuar, të pajisur me informacion të përditësuar mbi tendencat e reja të punës dhe kërkesat e tregut. Këto shërbime duhet të përshtaten sipas kontekstit të të rinjve në zona specifike në Shqipëri.

Duhet të zbatohen politika për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve në arsimin e lartë, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë reduktimit të barrierave për të rinjtë e marginalizuar. Mbështetja ekonomike dhe sociale për studentët e familjeve të marginalizuara do të kontribuonte në vazhdimësinë e studimeve dhe përparimin e tyre akademik. Iniciativa për të zvogëluar hendekun gjinor në arsim dhe për të siguruar pjesëmarrje të barabartë në arsimin e lartë janë gjithashtu të nevojshme.

# Shtojca 1:

## Shënime metodologjike

Që nga viti 2016, u përzgjedh një grup indikatorësh, bazuar në një proces analitik të përbërë nga hulumtime të thelluara në zyrë si dhe konsultime me ekspertë. Në tabelën e mëposhtme janë renditur të gjithë indikatorët, mënyra e llogaritjes si dhe burimet e të dhënave.

DIMENSIONI I PJESËMARRJES POLITIKE	METODA E LLOGARITJES SË TË DHËNAVE			BURIMI I TË DHËNAVE
	Të dhëna	Femër	Mashkull	
Ministrat e rinj në qeveri	Numri i ministrave të rinj (15-29) / Numri total i ministrave	Numri i ministereve të reja femra (15-29) / Numri total i ministrave	Numri i ministrave të rinj meshkuj (15-29) / Numri total i ministrave	Hulumtim
Zëvendësministrat e rinj në qeveri	Numri i zëvendësministrave të rinj (15-29) / Numri total i zëvendësministrave	Numri i femrave të reja zëvendësministre (15-29) / Numri total i zëvendësministrave	Numri i zëvendësministrave të rinj meshkuj (15-29) / Numri total i zëvendësministrave	Hulumtim
Deputetët e rinj në parlament	Numri i deputetëve të rinj (15-29) / Numri total i deputetëve	Numri i deputeteve të reja femra (15-29) / Numri total i deputetëve	Numri i deputetëve të rinj meshkuj (15-29) / Numri total i deputetëve	Hulumtim
Kryebashkiakë të rinj	Numri i kryetarëve të rinj (15-29) / Numri total i kryetarëve të bashkive	Numri i kryetareve bashkiake të reja femra (15-29) / Numri total i kryetarëve të bashkive	Numri i kryetarëve të rinj meshkuj (15-29) / Numri total i kryetarëve të bashkive	Hulumtim
Mjete on-line për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrjen e qeverisë dhe parlamentit	<b>Mesatarja</b> e (Numri i institucioneve publike në nivel qendror që kanë <b>Twitter</b> / Numri total i institucioneve publike në nivel qendror + (Numri i institucioneve publike në nivel qendror që kanë <b>Facebook</b> / numri total i institucioneve publike në nivel qendror) + (Numri i institucioneve publike në nivel qendror që kanë një <b>faqe interneti</b> / Numri i përgjithshëm i institucioneve publike në nivel qendror)	N/A	N/A	Hulumtim

Mjetet on-line për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrjen e bashkive	<b>Mesatarja e</b> (Numri i bashkive që kanë <b>Twitter</b> / Numri i përgjithshëm i bashkive) + (Numri i bashkive që kanë <b>Facebook</b> / Numri i përgjithshëm i bashkive) + (Numri i bashkive që kanë një <b>faqe interneti</b> / Numri total i bashkive)	N/A	N/A	Hulumtim
Ekzistenca e strukturave rinore (këshillat / parlamentet / bordet) në nivel kombëtar	Numri i strukturave rinore në nivel kombëtar	N/A	N/A	Informacioni i dhënë nga <b>Ministria e Rinisë dhe Fëmijëve dhe hulumtimi në zyrë</b>
Ekzistenca e strukturave rinore (këshillat / parlamentet / bordet) në nivel lokal	Numri i bashkive që kanë strukturë rinore (këshilla, parlamente, sindikata) / Numri total i bashkive.	N/A	N/A	Informacioni i dhënë nga <b>Bashkitë dhe Ministria e Rinisë dhe Fëmijëve</b>

DIMENSIONI I PJESËMARRJES EKONOMIKE	METODA E LLOGARITJES SË TË DHËNAVE			BURIMI I TË DHËNAVE
	Të dhëna	Femër	Mashkull	
Norma e NEET	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga <b>Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)</b>
Shkalla e papunësisë të të rinjve	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga <b>Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)</b>
Shkalla e papunësisë afatgjatë të të rinjve	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga <b>Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)</b>
Shkalla e pjesëmarrjes së forcës punëtore të të rinjve	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga <b>Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)</b>
Shkalla e punësimit të të rinjve	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga <b>Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)</b>
Të rinjtë që themeluan biznesin e tyre me mbështetjen financiare të shtetit	Numri i të rinjve (15-29) që kanë marrë mbështetje financiare nga qeveria (ministritë) / Numri total i njerëzve që kanë marrë mbështetje financiare nga qeveria (ministritë)	Numri i femrave të reja (15-29) që kanë marrë mbështetje financiare nga qeveria (ministritë) / Numri total i femrave që kanë marrë mbështetje financiare nga qeveria (ministritë)	Numri i të rinjve meshkuj (15-29) që kanë marrë mbështetje financiare nga qeveria (ministritë) / Numri total i meshkujve që kanë marrë mbështetje financiare nga qeveria (ministritë)	Informacioni i dhënë nga <b>Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</b>
Të rinjtë e vetëpunësuar	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga <b>Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)</b>

DIMENSIONI I PJESËMARRJES SOCIALE	METODA E LLOGARITJES SË TË DHËNAVE			BURIMI I TË DHËNAVE
	Të dhëna	Femër	Mashkull	
Të rinj në rrezik varfërie	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga <b>Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)</b>
Përqindja e të rinjve të varfër (të rinj që jetojnë nën vijën e varfërisë) (Jo i të rinjve të varfër / jo i të rinjve)	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	N/A
Të rinj në burgje	Numri i të rinjve (15-29) në burg / Numri total i personave në burg	Numri i femrave të reja (15-29) në burg / Numri total i personave në burg	Numri i të rinjve meshkuj (15-29) në burg / Numri total i personave në burg	Informacioni i dhënë nga <b>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</b>
Të rinj pjesë e sistemit të mbrojtjes sociale (të cilët marrin mbështetje financiare nën sistemin e mbrojtjes sociale) pjesëtuar me të rinjtë që janë në sistemin e mbrojtjes sociale	Të rinj (15-29) përfitues të skemës së ndihmës ekonomike / Totali personave përfitues të skemës së ndihmës ekonomike	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Informacioni i dhënë nga <b>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</b>
Të rinj të regjistruar në arsimin e lartë	Të dhënat e llogaritura dhe të siguruar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit	Të dhënat e llogaritura dhe të siguruar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit	Të dhënat e llogaritura dhe të siguruar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit	Informacioni i dhënë nga <b>Ministria e Arsimit dhe Sportit</b>
Braktisja e shkollës së mesme	Të rinj (18-29) të regjistruar në Arsimin e Lartë / Të rinj gjithsej (18-29)	Të rejat femra 18-29 vjeç të regjistruara në Arsimin e Lartë / Numri total i të rejave femra (18-29)	Të rinj meshkuj 18-29 vjeç të regjistruar në Arsimin e Lartë / Numri total i të rinjve meshkuj (18-29)	Informacioni i dhënë nga <b>Ministria e Arsimit dhe Sportit</b> dhe <b>Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)</b>
Të rinj të diplomuar në arsimin e lartë	Të rinj (18-29) të diplomuar në 2022 / Të rinj (18-29) të regjistruar në 2022	Të rejat femra (18-29) të diplomuar në 2022 / Të rejat femra (18-29) të regjistruar në 2022	Të rinj meshkuj (18-29) të diplomuar në 2022 / Të rinj meshkuj (18-29) të regjistruar në 2022	Informacioni i dhënë nga <b>Ministria e Arsimit dhe Sportit</b> dhe <b>Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)</b>
Shkalla e pjesëmarrjes në arsimin dhe trajnimin joformal (4 javët e fundit)	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga <b>Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)</b>

[www.partnersalbania.org](http://www.partnersalbania.org)

Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate,  
kati 10, ap. 71/73, Tiranë, Shqipëri

Partnerët Shqipëri  
për Ndryshim dhe Zhvillim

Projekti WB&T for EmploYouth po zbatohet nga:



**PARTNERSALBANIA**  
FOR CHANGE AND DEVELOPMENT

